


SITUATA ME GJUHËN E URREJTJES
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË
SË VERIUT NË VITIN 2023



DOKUMENT PËRMBLEDHËS
I POLITIKAVE PUBLIKE

DOKUMENT PËRMBLEDHËS I POLITIKAVE PUBLIKE

Situata me gjuhën e urrejtjes në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2023

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Shkup Janar, 2024

This publication was funded by the European Union. Its contents are the sole responsibility of the Helsinki Committee for Human Rights Skopje and do not necessarily reflect the views of the European Union.



Funded by
the European Union



Закнување на националните
заштитни механизми против
говор на омраза



PËRMBLEDHJE

Në vitin 2023, në platformën www.govornaomraza.mk u regjistruan 1171 raportime për gjuhë urrejtjeje. Shumica e raportimeve lidhen me përkatësinë etnike (646), orientimin seksual dhe identitetin gjinor (248), kombësinë (275), bindjet politike (149) dhe gjininë dhe seksin (80). Gjuha e urrejtjes është intensifikuar veçanërisht gjatë ngjarjeve me dukshmëri të lartë, siç është Skopje Pride, garat sportive dhe deklaratat publike nga aktorët politikë. Përkundër raportimeve të shumta, reagimi institucional mbeti i dobët – prokuroria pothuajse nuk merr fare veprime/aktivitete në bazë të kompetencave zyrtare.

PYETJE KYÇE:

- 1171 raportime: kryesisht sipas përkatësisë etnike (55%) dhe orientimit seksual/identitetit gjinor (21%).
 - Ngjarjet publike, zgjedhjet dhe fushatat mediatike janë arsytet më të zakonshme për një rritje të gjuhës së urrejtjes.
 - Rritje e ndjeshme e gjuhës së urrejtjes në qershor – Muaji i Krenarisë.
 - Vetëm 8 raportime në zyrën e prokurorit; 7 mbeten pa epilog.
 - KPMD ka proceduar vetëm 3 raste, një prej të cilave ka rezultuar me opinion për diskriminim.
 - Një ankesë u paraqit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut kundër një deklarate nga kreu i partisë politike Integra që përmbante gjuhë urrejtjeje.
 - Dy analiza të publikuara zbulojnë një boshllëk institucional dhe ligjor në trajtimin e gjuhës së urrejtjes.
-

Pasqyrë e detajuar e situatës me gjuhën e urrejtjes

Duke analizuar rastet e gjuhës së urrejtjes bazuar në përkatësinë etnike, vërehet se ky fenomen lind si rezultat i mungesës së mendimit kritik dhe shprehjes së pakënaqësisë ndaj autoriteteve shtetërore dhe politikave të saj; mbizotërojnë paragjykimet dhe stereotipet ndaj bashkësive të ndryshme etnike, të cilat më shpesh paraqiten si "e keqja" në shtet dhe si arsyeja e mosfunksionimit të sistemit. Fyerjet në baza etnike më shpesh kanë edhe një kontekst politik. Në rastet e regjistruara, vërehet edhe një diskurs që kthehet në konfliktin ushtarak të vitit 2001 dhe intensifikon gjuhën e urrejtjes.

Disa ngjarje përforcojnë gjuhën e urrejtjes me bazë etnike, siç janë fyerjet dhe gjuha keqdashëse ndaj dy komuniteteve më të mëdha etnike pas publikimit të lajmit se EVN furnizon me energji elektrike fshatin Sllupçan me shumicë shqiptare, ose ngritjen e flamurit të Shqipërisë së Madhe me rastin e pritjes së Kryeministrit të Kosovës dhe lajmin për hapjen e një rruge në Tetovë nga kryetari i bashkisë së Tetovës, kur flamuri i Shqipërisë së Madhe valëvitej në sallë.

Gjuha e urrejtjes është e përhapur dhe e dukshme në ndeshjet sportive, siç është ndeshja e futbollit midis Vardarit dhe Shkupit, ku sloganet ofenduese nacionaliste shkaktuan tensione ndëretnike dhe gjuhë urrejtjeje në mediat sociale.

Forma e dytë më e zakonshme e gjuhës së urrejtjes është kundër pakicave seksuale dhe personave me identitete të ndryshme gjinore në vend; u regjistruan 298 raste, ose 19% e numrit të përgjithshëm të raportimeve të gjuhës së urrejtjes. Komentet në rrjetet sociale shprehin neveri ndaj komunitetit LGBTI, si rezultat i paragjytimeve dhe lajmeve të rreme të përhapura kundër këtij komuniteti.

Numri i incidenteve të gjuhës së urrejtjes tregon një trend në rritje gjatë periudhave të caktuara, siç është Dita Ndërkombëtare e Dukshmërisë së Transgjjinorëve më 31 Mars, kur mbahet Marshi i Dukshmërisë së Transgjjinorëve i këtij viti. Në mediat sociale u vu re gjuhë transfobike, e shoqëruar me dezinformata që nxisin urrejtje dhe neveri ndaj këtij grupi të marginalizuar qytetarësh. Paragjykimi ndaj komunitetit LGBTI ishte veçanërisht i dukshëm më 17 Maj - Dita Ndërkombëtare Kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë. Në qershor, Muajin e Krenarisë, u regjistrua një numër rekord prej 105 rastesh (57%) të gjuhës së urrejtjes bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, si dhe 46 raste (25%) për shkak të përkatësisë etnike dhe 13 (7%) raste bazuar në kombësi.

Paragjykimet ndaj komunitetit LGBTI+ kanë dalë në dritë dhe gjuha e urrejtjes është rritur në përpjesëtim me dukshmërinë e këtij komuniteti. Nga konferenca për shtyp që njoftoi Paradën e Krenarisë më 4 qershor, deri në Paradën e Krenarisë më 24 qershor, u vunë re komente që nxisin urrejtje, nënçmonin, bënë thirrje për dhunë dhe likuidimin e këtij komuniteti. Edhe pse gjuha e urrejtjes në rrjetet sociale e drejtuar këtij komuniteti ishte e përhapur, prokuroria nuk nisi asnjë procedurë ex officio për të mbrojtur këtë komunitet nga gjuha e urrejtjes.

Gjatë kësaj periudhe, në Prokurorinë Publike të Shkupit dhe në Prokurorinë Publike të Gostivarit u raportuan 8 (tetë) raste dhe në Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi u raportuan 3 (tre) raste të gjuhës ngacmuese.

Nga 8 raportime në Prokurorinë Publike, 4 kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes bazuar në orientimin seksual, 2 mbi përkatësinë etnike, 1 mbi bazën e gjinisë dhe 1 mbi baza të shumëfishta, përkatësisht orientimin seksual dhe gjininë.

5 nga raportimet janë kallëzime penale për veprën penale të Përhapjes së materialit racist dhe ksenofobik nëpërmjet një sistemi kompjuterik sipas nenit 394d të Kodit Penal; 2 kallëzime penale për veprën penale Nxjitje të urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës kombëtare, racore ose fetare sipas nenit 319 të Kodit Penal,

një kallëzim penal për veprën penale Nxitje të urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës kombëtare, racore ose fetare sipas nenit 319 në lidhje me veprën penale të Rrezikimit të sigurisë të kryer nga urrejtja sipas nenit 144(3) të Kodit Penal dhe një kallëzim penal për veprën penale të Miratimit ose justifikimit të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit ose krimeve të luftës sipas nenit 407-a të Kodit Penal në lidhje me veprën penale të Përhapjes së materialit racor dhe ksenofobik nëpërmjet një sistemi kompjuterik sipas nenit 394d të Kodit Penal.

Një raportim i bazuar në orientim seksual u rrëzua nga zyra e prokurorit publik, ndërsa 7 të tjerat janë ende në procedurë e sipër.

Nga 3 rastet e gjuhës ngacmuese të raportuara në KPMD, 2 ishin të bazuara në orientimin seksual dhe një në gjininë. Në njërën prej këtyre rasteve, KPMD vendosi që diskriminimi në formën e gjuhës ngacmuese ishte kryer nga partia politike Integra kundër personave LGBTI+. 2 raportet e mbetura u refuzuan për shkak të parregullsive së ankesave. Kjo gjithashtu ngre sfidën e paraqitjes së ankesave për gjuhën ngacmuese në internet në rrjetet sociale, në kushtet kur Komisioni nuk ka një mekanizëm për të gjetur adresën e autorëve.

Një rast strategjik u iniciua para autoriteteve gjyqësore vendase dhe më vonë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Përfaqësimi strategjik

Ankuesja është një aktiviste e të drejtave të njeriut dhe të drejtave LGBTI në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e cila e ka kaluar të gjithë karrierën e saj profesionale duke i promovuar dhe mbrojtur ato, dhe gjithashtu është e hapur për orientimin e saj seksual si lezbike. Në kohën e incidentit, ankuesja ishte e punësuar nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

Më 11 prill 2023, personi Ljupčo Ristovski, si Kryetar i partisë politike Interga, dha një deklaratë që u transmetua dhe u publikua nga disa media elektronike - portale interneti, përkatësisht: www.24info.mk, www.a1on.mk, www.netpress.com.mk dhe www.vecер.press, me titull „Presion i tepruar mbi publikun me fushata mediatike LGBTI+“, të cilat përhapin gjuhë urrejtjeje kundër anëtarëve të komunitetit LGBTI+. Në një deklaratë të publikuar nga portalet e internetit, partia politike Integra dhe udhëheqësi i saj Ljupčo Ristovski reagojnë dhe theksojnë se ambasada e SHBA-së po ushtron presion të tepruar mbi publikun maqedonas në favor të aktiviteteve të komunitetit LGBTI+, duke i quajtur aktivitetet dhe orientimin e tyre seksual "të panatyrshëm", "në kundërshtim me natyrën" dhe çmenduri të shtrembëruar që duhet të mbetet në sferën private dhe të ndalojë së imponuari ato në shoqërinë maqedonase.

Deklarata gjithashtu thotë se fushatat mediatike po helmojnë fëmijët dhe pasardhësit me pikëpamje të shtrembëruara dhe djallëzore për botën, duke aluduar në pikëpamjet dhe vlerat e komunitetit LGBTI+. Përmes deklaratave me kontekst homofobik, nxitet që "anormalja nuk duhet të lejohet të bëhet normale" dhe "normalja të sulmohet nga anormalja" dhe se kjo e keqe (domethënë homoseksualiteti) duhet të ndalet dhe të pritët në rrënjë, kryesisht për hir të brezave të ardhshëm. Në të njëjtën kohë, deklarata thekson se brezave të tanishëm dhe të ardhshëm duhet t'u ofrohen kushte për rritje dhe zhvillim të duhur dhe të edukohen me një botëkuptim normal dhe të mirë, duke aluduar në faktin se botëkuptimi i anëtarëve të komunitetit LGBT+ është anormal dhe i pahijshëm dhe përfaqëson një eksperiment anësor të mendjes.

Me rastin e kësaj deklarate nga ankuesi dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, në prill të vitit 2023, në Prokurorinë Themelore Publike në Shkup u ngrit kallëzim penal kundër Partisë Politike Integra dhe kryetarit të saj Ljupčo Ristovski për veprën penale "Përhapja e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik" sipas nenit 394d të Kodit Penal.

Duke vepruar mbi kallëzimin penal, Prokuroria Themelore Publike, nëpërmjet prokurorit publik kompetent, në qershor 2023 nxori një vendim me të cilin e hodhi poshtë kallëzimin penal

sepse vepra penale e raportuar nuk është vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, me shpjegimin se nuk mund të përcaktohej asnjë veprim i përhapjes së materialit racist dhe ksenofobik nëpërmjet një sistemi kompjuterik që do të promovonte dhe nxiste urrejtje ndaj palëve të dëmtuara, por përkundrazi se bëhej fjalë për mosmiratim, mospranim të aktiviteteve të komunitetit LGBTI nëpërmjet shprehjes së një mendimi personal për këtë komunitet.

Të pakënaqur me vendimin e Prokurorisë Themelore Publike Shkup, ankuesit paraqitën ankesë në Prokurorinë e Lartë Publike Shkup. Duke vepruar sipas ankesës, Prokuroria e Lartë Publike Shkup e hodhi poshtë ankesën si të pabazuar dhe e konfirmoi Vendimin e shkallës së parë. Arsyet për refuzim janë identike me ato të deklaruara në vendimin me të cilin u hodh poshtë kallëzimi penal i ngritur nga Prokuroria Themelore Publike Shkup, pa studim dhe shqyrtim të duhur të pretendimeve në ankesë. Me këtë, vendimi për të mos filluar procedurë penale kundër të raportuarve para gjykatave kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut është bërë i formës së prerë dhe të gjitha mjetet juridike sipas rregulloreve të brendshme janë shteruar kundër këtij vendimi, me ç'rast Republika e Maqedonisë së Veriut, edhe një herë, si pjesë e një fenomeni kronik, lejon që fenomene të tilla tendencioze të përhapjes së gjuhës së urrejtjes që i karakterizon anëtarët e komunitetit LGBTI si anormale

dhe të pahijshme të mbeten të pandëshkuara. Për shkak të kësaj, ankuesi dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut paraqitën një ankesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për shkelje të Nenit 8 "E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare", Nenit 14 "Ndalimi i diskriminimit" dhe Nenit 17 "Ndalimi i abuzimit me të drejtat" të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Me rastin e kësaj deklarate nga ankuesi dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, në prill të vitit 2023, në Prokurorinë Themelore Publike në Shkup u ngrit kallëzim penal kundër Partisë Politike Integra dhe kryetarit të saj Ljupčo Ristovski për veprën penale "Përhapja e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik" sipas nenit 394d të Kodit Penal.

Conclusions

- 1. Rrjetet sociale janë vendi më i zakonshëm për përhapjen e gjuhës së urrejtjes, pa kontroll të mjaftueshëm institucional.**
- 2. Komuniteti LGBTIQ+ përballet me sulme të organizuara dhe sistemike në hapësirën online.**
- 3. Zyra e Prokurorit Publik nuk reagon në kohën e duhur dhe nuk e njeh seriozitetin e akteve.**
- 4. Ekzistojnë pengesa të konsiderueshme ligjore dhe institucionale për ndjekje penale efikase.**
- 5. Nevojitet një strategji kombëtare e koordinuar e bazuar në të dhëna, analiza dhe standarde ndërkombëtare.**

REKOMANDIME

- Miratimi i një strategjie kombëtare për të luftuar gjuhën e urrejtjes.
- Forcimi i kapaciteteve të prokurorisë, policisë dhe KPMD për të vepruar ndaj gjuhës së urrejtjes.
- Mekanizëm për identifikimin dhe monitorimin e autorëve në rrjetet sociale.
- Ndryshime në Kodin Penal për të përcaktuar saktësisht gjuhën e urrejtjes si krim.
- Zhvillimi i mjeteve për regjistrimin dhe monitorimin e rasteve nga institucionet.
- Mbështetje për avokim strategjik dhe procedura para gjykatave kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Programe edukative dhe njohuri mediatike për të luftuar stereotipet dhe paragjykimet.
- Raporte të rregullta institucionale dhe transparencë në veprim.



Funded by
the European Union



Зајакнување на националните
заштитни механизми против
говор на омраза



ХЕЛСИНШКИ
КОМИТЕТ
ЗА ЧОВЕКОВИ
ПРАВА